

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® WT-140 L

ADITIV HIDROIZOLUES PËR BETON DHE LLAÇ - PJESË E KONCEPTIT SIKAR® WATERTIGHT CONCRETE CONCEPT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® WT-140 L është aditiv i lëngët hidroizolues që përdoret për reduktim të përshkueshmërisë së ujit tek betoni dhe llaçet me bazë çimentoje. Në kombinim me superplastifikuesit Sika® ViscoCrete® dhe Sika® ViscoFlow®, mund të prodhohet beton me veti tepër të përmirësuara, për sa i përket absorbueshmërisë kapilare të ujit dhe depërtimit të ujit nën presion.

PËRDORIMET

Sika® WT-140 L është formuluar posaçërisht për prodhimin e llaçeve dhe betonit të hidroizoluar. Është gjithashtu pjesë e konceptit Sika® Watertight Concrete Concept. Llojet e konstruksioneve ku mund të përdoret janë:

- Ndërtesa, themele dhe kudo që kërkohet beton i hidroizoluar
- Rezervuarë dhe diga
- Konstruksione nën ujë
- Pishina

Për llaçe me bazë çimentoje të hidroizoluara mund të përdoret në:

- Struktura mbi dhe nën dhë të mureve
- Hidroizolim në struktura betoni
- Prodhim pjesësh të vogla me bazë çimentoje me shkallë të lartë rezistence ndaj ujit dhe ndikimeve të motit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Reduktim i përshkueshmërisë ujit në beton dhe llaçet me bazë çimentoje
- Reduktim i depërtimit të ujit tek betoni dhe llaçet me bazë çimentoje në kombinim me superplastifikuesit Sika® ViscoCrete® dhe Sika® ViscoFlow®

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance si aditiv me rezistencë ndaj ujit (Tabela 9) sipas EN 934-02:2009+A1:2012, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimin e llojit.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përbërje pjesërisht e neutralizuar e amino-alkooleve
Ambalazhi	Rifuxho, IBC, fuçi 210 kg dhe bidona plastikë 5 dhe 20 kg
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, ngjyrë rozë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.02 kg/lit (në +20°C)
Vlera e pH	8.0-10.0 (në +20°C)
Përmbajtja totale e joneve të klorurit	Nuk ka (EN 934-01)

TË DHËNA TEKNIKE

Udhëzime për betonimin

Duhet të ndiqen rregullat standarde të praktikës së saktë të betonimit për sa i përket prodhimit dhe vendosjes. Referohuni tek standardet përkatëse. Betoni i freskët duhet të maturohet sipas mënyrës së duhur. Prodhimi i shtresës kryesore të hidroizolimit me Sika® WT-140 L duhet bërë bazuar në udhëzimet e konsumimit, në varësi të përmbajtjes së çimentos tek llaçi.

Këshilla specifike

Për aplikim llaçi: Nënshtrësas duhet të jenë të pastra dhe pa vaj, graso, veshje të vjetra, kore çimentoje (qumësht) dhe grimca të lira. Nënshtrësas duhet të lahet dhe të laget deri në ngopje. Hiqni të gjithë ujin e grumbulluar nga sipërfaqja përpara aplikimit. Në rast se do të nevojitet një shtresë ngjitjeje, përdorni Sika® ViscoBond® sipas skedës teknike përkatëse. Aplikoni menjëherë mbi shtresën e ngjitjes (të lagur mbi të lagur). Përpara aplikimit të llaçit të përgatitur me Sika® WT-140 L, betoni duhet të jetë maturuar për të paktën 14 ditë.

Përbërja e betonit

- Për beton me përshkueshmëri të reduktuar sipas Rregullores Kombëtare Greke për Teknologjinë e Betonit: Ju lutemi referohuni tek § B7.6 të Rregullores siç vlen për udhëzimet specifike në lidhje me recetën e miksit.
- Për beton të hidroizoluar Sika®: Sika® WT-140 L është krijuar për të gjitha llojet e betonit. Në përgjithësi, rekomandohet adaptimi i sugjerimeve të Sika-s për prodhim Betoni të Hidroizoluar, i cili do të ketë përmbajtje minimale çimentoje 350 kg/m³ dhe raport aktiv maksimal U/Ç = 0.45. Në varësi të kërkesave specifike të miksit për çdo aplikim, duhet të vlerësohet shtimi i superplastifikuesit për arritjen e kategorisë së konsistencës S3/S4 (EN 206-1).
- Për llaç të hidroizoluar: Preferohet të përdoret çimento me datë të afërt prodhimi dhe rërë të larë, jo rërë deti.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

1.5% për peshë çimentoje

Kompatibiliteti

Sika® WT-140 L mund të kombinohet me produktet e mëposhtme Sika:

- Superplastifikuesit Sika® ViscoCrete®
- Superplastifikuesit Sika® ViscoFlow®
- Superplastifikuesit SikaPlast®
- Vonuesit Sika® Plastiment®
- Produktet me përmbajtje tymi silici (silica fume) Sikacrete® UCS / Sikacrete® AR

Në të gjitha rastet, rekomandohet kryerja e provave përpara kombinimit të produkteve.

Përpara aplikimit duhet të kryhen testime përshtatshmërie.

Mënyra e aplikimit

- Sika® WT-140 L shtohet në ujin e përzierjes në fabrikë ose në kantier brenda miksit të freskët tek auto-betonierja.
- Sika® WT-140 L shtohet në llaçin e freskët ose në ujin e përzierjes.

KUFIZIME

- Përdorimi i Sika® WT-140 L duhet bërë bazuar mbi një recetë të përshtatshme dhe duhet të testohet burimi i materialeve vendase.
- Sika® WT-140 L nuk duhet të shtohet në çimento të thatë.
- Sika® WT-140 L duhet të shtohet në ujin e përzierjes ose në miksionin e freskët të betonit/ llaçit.
- Llaçi i përgatitur me Sika® WT-140 L duhet të përdoret për aq kohë sa ruan punueshmërinë e tij.
- Në lidhje me tharjen e llaçit/ betonit të përgatitur me Sika® WT-140 L, duhet të ndiqen të njëjtat rregulla që zbatohen për llaçin/ betonin konvencional. Llaçi i

përgatitur me Sika® WT-140 L duhet të mbrohet gjatë fazës së maturimit të tij, sidomos gjatë verës ose kur lagështia relative është e ulët.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® WT-140 L

Maj 2019, Botimi 01.01

021403011000000154

SikaWT-140L-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf